

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIV, nr. 7941
E mërkurë, 27 nëntor 2024
Çmimi 0.50

Haradinaj: Më 9 shkurt duhet të ndalet trendi i humbjeve



Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

PASIVIZIMI I ADRESAVE NË LUGINË, DREJT GJYKATËS SË STRASBURGUT

FAQE 4-5



Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut në Strasburg do të jetë adresa e radhës ku do të drejtohet Safet Demiri nga fshati Banjë e Sijarinës në jug të Serbisë. Ai pretendon se

autoritetet e këtij vendi ia kanë pasivizuar pa të drejtë adresën në këtë fshat të Medvegjës qysh në vitin 2019. Për plot pesë vjet ai iu drejtua instancave të ndryshme gjyqësore në Serbi,

derisa Gjykata Kushtetuese e vendit ia hodhi poshtë ankesën në mes të këtij muaji. Rasti i tij nxiti reagimin e autoriteteve në Kosovë, por edhe në Bashkimin Evropian

HALIL ÇADRAKU, DËSHMITARI I 107 NË PROCESIN GJYQËSOR NDAJ LIDERËVE TË UÇK-SË

ÇADRAKU: BRENDA ŠTRUKTURAVE OKUPATORE KISHTE SHOIPTARË. MË VJEN TURP PËR ATA

F. 6



'MOS IA MBANI ANËN PROKURORISË', LIDERËT E UÇK-së NË HAGË U SHKRUAJNË LETËR TË ASHPËR GJYQËRËVE TË SPECIALES

F. 8



AKTUALE



BE-ja I BËN THIRRJE IZRAELIT TA PRANOJË MARRËVESHJEN E ARMËPUSHIMIT ME HEZBOLLAHUN

F. 2

INAUGUROHET BUSTI I HEROIT KOMBËTAR HASAN PRISHTINA NË TROPOJË

F. 3

KOALICIONIT AAK-NISMA I BASHKOHET "LISTA IDEALI" E NUREDIN LUSHTAKUT

F. 3

EKONOMI



KONVENTA E DRURIT, KURTI: KOSOVA PO E GDHEND NJË VEND TË VEÇANTË NË TREGUN GLOBAL

F. 8

PECI: GRATË E KRUSHËS I SUBVENCIONUAM ME MBI 1 MILION E 900 MIJË EURO

F. 8

SPORT



KOSOVA NIS PËRGATITJET PËR MIQËSORET NDAJ ESTONISË

F. 10

RENOVA
Maqedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
PUTZ
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
E-mail: renova@mt.net.mk
Mobi: +377 44 501289

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë.
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

BE-ja i bën thirrje Izraelit ta pranojë marrëveshjen e armëpushimit me Hezbollahun

BRUKSEL, 26 NËNTOR - Shefi i diplomacisë i Bashkimit Evropian, Josep Borrell, tha se “nuk ka asnjë justifikim” për Izraelin që ta refuzojë zbatimin e një armëpushimi me Hezbollahun, grupin militant dhe partinë politike që kontrollon shumicën e jugut të Libanit.

Borrelli tha se të gjitha shqetësimet e sigurisë të Izraelit janë adresuar në marrëveshjen e ndërmjetësuar nga Shtetet e Bashkuara dhe Franca.

Zyrtari i lartë evropian bëri thirrje për rritjen e presionit ndaj Izraelit për ta mposhtur linjën ekstremiste brenda qeverisë izraelite e cila po refuzon ta pranojë marrëveshjen.



Duke folur në margjinat e takimit të Grupit të Shtatë shteteve më të industrializuara (G7) në Itali, Borrelli paralajmëroi se nëse marrëveshja për armëpushim nuk zbatohet, “Libani do të

shpërbëhet”. Zyrtarët izraelitë thanë se kabineti i sigurisë i kryeministrit Benjamin Netanyahu do të mbledhet më 26 nëntor për të diskutuar për armëpushimin e propozuar. Në

mesin e çështjeve që mbesin të pazgjidhura është një kërkesë e Izraelit për të rezervuar të drejtën për të vepruar nëse Hezbollahu shkel obligimet nga marrëveshja e re.

Hezbollahu është shpallur organizatë terroriste nga Shtetet e Bashkuara, ndërsa Bashkimi Evropian e ka vendosur në listën e zezë krahun e tij të armatosur, por jo edhe partinë e tij politike.

Borrelli tha se ShBA-ja do ta udhëhiqte komitetin për zbatimin e armëpushimit, por Franca do të merre pjesë në të me kërkesën e Libanit. “Në marrëveshjen e propozuar, të ndërmjetësuar nga ShBA-ja dhe Franca, Izraeli i ka të adresuara të gjitha shqetësimet e sigurisë.

Nuk ka asnjë justifikim për moszbatimin e një armëpushimi”, tha Borrelli për gazetarët.

Hezbollahu nisi sulmet në kufi kundër Izraelit më 8 tetor 2023, një ditë pasi Hamasi - grupi palestinez i shpallur organizatë terroriste nga ShBA-ja dhe BE-ja - sulmoi jugun e Izraelit, që nxiti luftën në Gazë.

Luftimet në mes të Hezbollahut dhe Izraelit u përshkallëzuan shtatorin e këtij viti, me Izraelin që nisi sulme masive ajrore në Liban dhe më pas nisi një ofensivë tokësore në jug të Libanit.

Hezbollahu ka gjuajtur mijëra raketa në qytetet izraelite, përfshirë rreth 250 që i lëshoi më 24 nëntor.

Rrëzimi i avionit në Lituani ngre dyshime se mund të jetë i lidhur me sabotim

BERLIN, 26 NËNTOR - Ministrja e Jashtme e Gjermanisë, Annalena Baerbock, ka thënë se rrëzimi i një avioni mallrash në Lituani më 25 nëntor mund të ketë qenë “incident hibrid” me ndërhyrje nga jashtë. “Tani duhet ta pyesim veten seriozisht nëse ky ishte aksident, apo nëse ishte një incident tjetër hibrid”, tha Baerbock për gazetarët në takimin e ministrave të Jashtëm të G7-s në Itali. “Së voni kemi parë shumë sulme hibride në Evropë, të cilat shpesh në shënjestër kishin individët dhe infrastrukturën, qoftë atë nënujore apo në sipërfaqe”, tha ajo, duke aluduar në këputjen e kablove të telekomit në Detin Baltik rishtazi, për çka zyrtarët kanë thënë se mund të ketë

qenë sabotim.

Autoritetet e Lituani nuk e kanë bërë një lidhje të tillë me rrëzimin e avionit.

Shumë agjenci perëndimore të inteligjencës e kanë akuzuar Moskën për përfshirje në akte sabotimi në Evropë, të cilat, sipas tyre, kanë për qëllim destabilizimin e aleatëve të Ukrainës sepse ajo mbështetet te qeveritë perëndimore në luftën e saj kundër pushtimit të plotë nga Rusia.

Avioni i mallrave, që i përkiste kompanisë DHL, u rrëzua derisa po përpiqej të ulej në aeroportin e Vilniusit. Si pasojë u vra piloti spanjoll i avionit dhe u plagosën një tjetër anëtar ekuipazhi spanjoll, një gjerman dhe një lituan, sipas zyrtarëve të aeroportit dhe policisë të cituar



nga “Reuters”.

Zjarrfikësit nuk kanë qenë në gjendje ta zbulojnë nëse avioni kishte filluar të digjej ose të copëtohej sa ishte ende në ajër. Autoritetet janë ende në kërkim të kutive të zeza që regjistrojnë të dhënat e fluturimit.

Komisionari i Përgjithshëm i Policisë Lituanëze, Arunas Paulauskas, tha se anëtarët e mbijetuar të ekuipazhit u treguan hetuesve se nuk kishte tym, zjarr apo ndonjë situatë emergjente në kabinë para rrëzimit të tij. Ai, gjithashtu, tha

se mundësia e ndonjë ndikimi nga një forcë e jashtme është shumë e ulët.

Rrëzimi i avionit ndodhi pas një sërë zjarresh në depot e DHL-së në Britani dhe Gjermani gjatë verës.

Zyrtarë perëndimorë të sigurisë janë cituar më herët këtë muaj ta kenë lidhur serinë e zjarreve me një operacion të dyshuar rus që kishte për synim shkatërimin e zjarreve në avionë mallrash ose pasagjerësh që udhëtonin drejt Amerikës së Veriut.

“The Wall Street Journal” citoi zyrtarë të sigurisë duke thënë se pajisjet që u ndezën në korrik në depot e DHL-së në Lajpcig dhe qytetin britanik të Birminghamit ishin pjesë e një prove.

Prokurori vendos t’i pushojë rastet ndaj Trumpit për ndërhyrje në zgjedhje dhe dokumente të klasifikuara

UASHINGTON, 26 NËNTOR - Prokurorët federalë kanë vendosur të hënë ta pushtojnë aktakuzën kundër presidentit të zgjedhur të Shteteve të Bashkuara, Donald Trump, e cila ngarkonte atë me komplot për ta përmbytur rezultatin e zgjedhjeve presidenciale të vitit 2020, si dhe të heqin dorë nga çështja tjetër gjyqësore kundër tij për dokumentet e klasifikuara. Ata e cituan politikën e kamotshme të Departamentit Amerikan të Drejtësisë e cila i mbron presidentët në detyrë nga ndjekja penale, në kërkesën e tij për ta hedhur poshtë rastin kundër Trumpit.

Vendimi i marrë nga prokurori i posaçëm, Jack Smith, i cili kishte luftuar për ta mbajtur Trumpin përgjegjës për përpjekjet e tij për ta zhbërë humbjen në zgjedhjet e 2020-s do të thotë se me kaq merr fund ndjekja penale ndaj ish-presidentit, pasi ai i fitoi zgjedhjet këtë muaj.

Ekipi i Smithit theksoi se vendimi për të hequr dorë nga ndjekja penale, në gjykatat federale në Uashington dhe Florida, nuk pasqyron qëndrimin e tyre për meritat e këtyre dy çështjeve ligjore, por pasqyron përkushtimin e tyre ndaj politikës së kamotshme të departamentit.



Prokurorët e Departamentit të Drejtësisë, duke cituar udhëzimin e kamotshëm të departamentit që një president

në detyrë nuk mund të ndiqet penalisht, thanë se qëndrimi i departamentit është se “Kushtetuta kërkon që ky rast të hidhet poshtë para se i pandehuri të inaugurohet”. Ky vendim pritej, pasi ekipi i Smithit filloi shqyrtimin e dhënies fund të dy rasteve - ndërhyrjes në zgjedhjet e vitit 2020 dhe rastit tjetër për dokumentet e klasifikuara - pasi Trumpi e mposhti nënpresidenten Kamala Harris në zgjedhjet e 5 nëntorit.

Departamenti i Drejtësisë beson se Trumpi nuk mund të gjykohej më, pasi politika e departamentit thotë se presidentët në detyrë nuk

mund të ndiqen penalisht.

Trumpi i ka cilësuar të dyja rastet kundër tij si të motivuara politikisht dhe është zotuar se do ta shkarkojë Smithin sapo ta marrë detyrën në janar.

Aktakuza në lidhje me zgjedhjet e vitit 2020, e ngritur vitin e kaluar, dikur shihej si një nga kërcënimet më serioze ligjore me të cilat përballej Trumpi në rrugën e tij për t’u kthyer në Shtëpinë e Bardhë. Por, ky rast kundër tij ngeci shpejt në mes të betejave ligjore pas pretendimeve të mëdha të Trumpit se ai gëzonte imunitet nga ndjekja penale për veprime që i ndërmori gjatë kohës sa ishte në Shtëpinë e Bardhë.

Koalicioni AAK - Nisma i bashkohet "Lista Ideali" e Nuredin Lushtakut

PRISHTINË, 26 NËNTOR - Koalicioni AAK, Nisma, Lista Konservatore dhe Forumi Intelktual E-30, të martën zyrtarisht iu bashkua edhe "Lista Ideali" e udhëhequr nga Nuredin Lushtaku. "Edhe zyrtarisht nënshkruam koalicionin me kryetarin e

Idealit për Skenderaj, gjeneral Nuredin Lushtaku. Ideali për Skenderaj ka dëshmuar se në çdo etapë është burim i pashtershëm për t'i shërbyer Kosovës, sa herë që shfaqet nevoja. Koalicioni jonë tashmë është kthyer në bosht të

personaliteteve me bagazh të cilët në jetën e tyre kanë vepra më shumë se fjalë, andaj qytetarët e Kosovës tanimë e kanë rastin që të përfaqësohen denjësisht pas zgjedhjeve të 9 shkurtit", ka shkruar në "Facebook" kryetari i Nismës, Fatmir Limaj.



Inaugurohet busti i heroit kombëtar Hasan Prishtina në Tropojë



TROPOJË, 26 NËNTOR - Fondacioni "Hasan Prishtina", në bashkëpunim me Bashkinë Tropojë, kanë inauguruar bustin e heroit kombëtar Hasan Prishtina në Tropojë, ngjarje e cila organizohet në nderim të Ditës së Flamurit. Aty u tha se heroi kombëtar Hasan Prishtina ishte udhërrëfyes i gjeneratave ndër vite, duke filluar nga Ukshin Hoti e deri tek ish-ushtarët e UÇK-së. Mehmet Prishtina, kryetar i

Fondacionit "Hasan Prishtina", tha se u realizua një qëllim i kamotshëm që të rikthehet pranë Bajram Currit edhe figura e kolosit shqiptar Hasan Prishtina. Ai tha se që të dy, Curri dhe Prishtina, luftuan derisa vdiqën për të njëjtën kauzë. "Sot është një ditë e bekuar sepse edhe moti po na përcjellë me diell sikur po na ngroh zemrat tona sepse arritëm që ta rikthejmë kolosin tonë, heroin kombëtar Hasan Prishtina, kryeministrin e tetë

të Shqipërisë, një figurë e cila flet vetë dhe jorastësisht këtu krahas heroit Bajram Curri, sepse ata jetuan, luftuan dhe derisa vdiqën së bashku për të njëjtën kauzë, për qëllimin e bashkimit të kombit shqiptar. Këtu ka qenë një ëndërr e kamotshme dhe një porosi e babait tim që mos të merrem me figurën e tij sepse ishim në luftë dhe vdiq dhe, siç thoshte ai, 'unë jam i pashkollë', por i kemi figurat që peshojnë rëndë në sallën e historisë, andaj të

merresh me Hasan Prishtinën", u shpreh Prishtina. Kryetari i Këshillit Bashkiak të Tropojës, Arber Çakraj, ka thënë se Hasan Prishtina përfaqësoi lëvizjet kombëtare për liri dhe pavarësi si dhe organizoi kryengritje shqiptare. "Hasan Prishtina është një nga ideologët kryesorë të çlirimit dhe bashkimit të shqiptarëve. Vepra dhe tërë jeta e tij kanë qenë të lidhura me fatin e kombit dhe atdheut. Në rrugën

jetësore iu kishte përmbajtur motos 'Kam mem shtrub vetëm vdekja'. Krejt ideja e tij jetësore, trimëria dhe temperamentit tipik i shqiptarit, jo vetëm luftëtar, ai përfaqësoi lëvizjet kombëtare për liri dhe pavarësi, si dhe organizoi kryengritje shqiptare", u shpreh ai. Ndërsa ish-ambasadori i Shqipërisë në Kosovë, Arben Çejku, tha se asnjëherë nuk është ndër diplomat por, siç tha, si në shtëpinë e vet.

LV-ja shpall zgjedhjet e brendshme për kandidatët për deputetë për zgjedhjet e 9 shkurtit

PRISHTINË, 26 NËNTOR - Në përputhje me statutin e Lëvizjes Vetëvendosje dhe Rregulloren e Zgjedhjeve të Brendshme, Komisioni Zgjedhor i Përgjithshëm i Lëvizjes Vetëvendosje ka shpallur zgjedhjet e brendshme për kandidatët për deputetë për zgjedhjet parlamentare të 9 shkurtit 2025. "Të gjithë anëtarët e

Lëvizjes, të interesuar për të kandiduar në këto zgjedhje, duhet të paraqesin deklaratën e kandidaturës me dokumentacionin shoqëruar nga data 26.11.2024 deri me datë 30.11.2024. Në secilën Qendër të Lëvizjes Vetëvendosje! janë ngritur Komisionet Zgjedhore Ad-Hoc të Qendrave, ku anëtarët

e interesuar mund të drejtohen për çdo informacion të mëtejshëm. Me besimin e plotë në vlerat e demokracisë sonë të brendshme dhe në respektim të Statutit, ky proces synon të çojë përpara kandidatët dhe kandidatët më të përgatitur për fitoren plebishitare të Lëvizjes Vetëvendosje!", ka njoftuar LV-ja.





HALIL ÇADRAKU, DËSHMITARI I 107 NË PROCESIN GJYQËSOR NDAJ LIDERËVE TË UÇK-SË

Çadraku: Brenda strukturave okupatore kishte shqiptarë. Më vjen turp për ata

- E falënderoj Thaçin në emrin tim, të familjes sime dhe popullit për punën gjigante

Në procesin gjyqësor ndaj liderëve të UÇK-së në Hagë është duke dëshmuar ish-kreu i G2-shit në Zonën Operative të Pashtrikut, Halil Çadraku, i cili u është përgjigjur pyetjeve të prokurorit në lidhje me angazhimin e tij në UÇK. Çadraku ka treguar se brenda strukturave okupatore serbe ka pasur edhe shqiptarë të cilët kanë punuar kundër Kosovës. Ai ka thënë se i vjen keq për ata.

Çadraku është pyetur edhe për liderët e UÇK-së e Hashim Thaçin e ka quajtur gjigant. Madje Çadraku e ka falënderuar Thaçin para trupit gjykues në Hagë për punën në shërbim të çlirimit dhe pavarësisë së Kosovës

EPOKA ERE

Lirim GECI

HAGË, 26 NËNTOR - Ish-kreu i G2-shit në Zonën Operative të Pashtrikut, Halil Çadraku, është duke dëshmuar në Gjykatën Speciale në procesin gjyqësor ndaj liderëve të UÇK-së, Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit. Fillimisht, Çadraku është marrë në pyetje nga Zyra e Prokurorit të Specializuar (ZSP) në lidhje me angazhimin e tij në Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës (UÇK).

Çadraku në ditën e parë të dëshmisë ka folur për rolin e tij si pjesë e G2-shit apo sektorit të Zbulim-Kundërzbulimit në Zonën Operative të Pashtrikut.

Ai e ka bërë dallimin në mes të sektorit të Zbulimit dhe atij të Kundërzbulimit, për çfarë ka thënë se ky sektor i fundit mblidhte informacione sa iu takon elementeve të dëmshme për UÇK-në. Dëshmitari ka thënë se pjesë e këtyre elementeve apo strukturave okupuese kishte edhe shumë shqiptarë, për të cilët ai ka theksuar se i vjen turp. Çadraku ka thënë se këto shërbime serbe ishin të sofistikuar dhe përdornin forma të ndryshme që të zbulohen informacione nga UÇK-ja, duke shtuar se brenda tyre kishte edhe shqiptarë. “Brenda strukturave të shtetit serb ka pasur shumë struktura ilegale, shumë struktura të hapura të UDB-së që ishin

pjesë e Sigurimit Shtetëror, që ishin pjesë e milicisë serbe apo ish-pjesëtarë të Milicisë serbe, sepse ata kanë shfrytëzuar të gjitha resurset e tyre ose me dëshirë ose me shantazh dikë kanë mundur ta shantazhojnë. Por, ka pasur elemente shqiptare brenda këtyre edhe pse ishte strukturë serbe, strukturë okupatore”, ka thënë Çadraku.

Ai është pyetur se nga e dinte se pjesë e këtyre strukturave kishte shqiptarë. “Sigurimi shtetëror në ato vende ku kam jetuar unë, Rahovec, Prizren dhe në qytete të tjera, të gjithë pjesëtarët e UDB-së kanë qenë shqiptarë. Brenda UDB-së ka pasur disa. Veç Prizreni i ka pasur 10 apo 12 dhe të gjithë ishin trupërisht shqiptarë, për

të cilët më vjen turp mua për ata, por ata edhe pse sot ndoshta mund të ndihen krenarë për atë punë që kanë bërë, por ata kanë qenë pjesë e UDB-së deri vonë, ashtu kishte edhe Rahoveci, e ashtu kishin edhe qytetet e tjera. Ata janë me emra e mbiemra. I njeh bota, i njeh Kosova, i njihni edhe ju ndoshta”, ka deklaruar Çadraku. Sipas tij, këta persona i kanë njohur me emra, sepse ata nuk e kanë fshehur veten e tyre kurrë për atë që ishin. “Atyre personave ua kemi ditur emrin edhe para ‘98-s e ‘99-s”, ka thënë dëshmitari Çadraku.

Dëshmitari Çadraku ka treguar se kush ishte pjesë e ZKZ-së. “Unë kam qenë shef i të dy sektorëve. Sektorit të Zbulimit dhe sektorit të Kundërzbulimit. Shef i sektorit të Zbulimit ka qenë deri më 2 maj Xhavit Bajraktari dhe, pas vrasjes së tij, atë e ka zëvendësuar Isuf Krasniqi - ‘Mësuesi’. Kurse në sektorin e Kundërzbulimit ka qenë Nezir Çoçaj, e unë kam qenë shef i Zbulim-Kundërzbulimit, pra të dyjave”, ka thënë Çadraku, duke treguar edhe detyrat e tij. “Detyra ime që nga janari kur e kam marrë, ka qenë ruajtja,

mbrojtja e të gjitha formacioneve tona ushtarake dhe territorit sado të lirë që ne operonim, që ta ruajmë dhe mbrojmë nga armiqët dhe ata që duan të na bënin dëme neve. Fillimisht, kur unë e mora këtë detyrë kam ardhur në Kosovë. Asgjë nga ky sektor nuk ishte formuar brenda Zonës Operative të Pashtrikut ku unë isha emëruar. Brenda atyre brigadave që operonin brenda vendit ishin përfaqësuar pesë brigada që operonin. Shumicën e kohës kam tentuar që të bënim organizimin, plotësimin, emërimin e sektorëve nga lart-poshtë. Nuk kishim kohë të mjaftueshme për ta realizuar këtë sepse ndodhën shumë gjëra, ndodhën shumë operacione, luftime, por detyra ime në atë kohë ka qenë përfaqësuar konsolidimi i sektorit tim nga Zona Operative e Pashtrikut e teposhtë, në Brigada e batalione e kompani”, ka thënë Çadraku.

Dëshmitari ka thënë se roli i tij ishte grumbullimi i informacionit, analizimi dhe raportimi te komandanti që, sipas tij, komandant i tij ishte Ekrem Rexha - “Drini” dhe më



vonë Tahir Sinani. Çadraku ka thënë se në sektorin e zbulimit, në kushte normale bënte zbulimin e forcave të armikut, vlerësimin e tij, vlerësimin e rrezikshmërisë së fatkeqësive. Ndërsa në bazë të asaj që ia kishte shpjeguar komandant "Drini", dëshmitari ka thënë se sektori i Kundërzbulimit e kishte për detyrë ruajtjen e territorit nga elemente të jouniformuara, por që ndoshta do të ishin më të dëmshme se forcat e armikut. Veç të tjerash, dëshmitari Çadraku ka thënë se shpesh civilët raportonin se një person ishte bashkëpunëtor. Si rrjedhojë, Çadraku ka thënë se bëhej analiza e biografisë, historikut dhe personit në fjalë që vendosej më pas se a duhej të njoftoheshin rojet apo jo. Dëshmitari ka pohuar se në Zonën Operative të Pashtrikut kishte postbllaqe të cilat, sipas tij, janë vendosur në ato vende ku kishte rrezik që të hynin persona të paautorizuar me qëllim legjitimimi dhe ruajtje territori. Ai ka thënë se për herë të parë janë ngritur në fshatin Drenoc, më 26 prill të 1998-s.

Çadraku flet për katërshen e UÇK-së dhe anëtarët e tjerë

Dëshmitari Halil Çadraku gjatë dëshmisë së tij në Hagë ka folur edhe për anëtarët e Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, duke përfshirë katër liderët e UÇK-së si dhe për Sokol

Bashotën. Për Jakup Krasniqin, dëshmitari ka thënë se ka qenë zëdhënës i UÇK-së dhe një gjë të tillë e kishte kuptuar përmes medieve. "Sipas njohurive të mia, nga qershori i vitit 1998 Krasniqi ka qenë zëdhënës i UÇK-së. Unë mendoj që ka qenë një publikim në medie, ose përmes gazetës ose në televizor që Jakup Krasniqi është përzgjedhur zëdhënës i UÇK-së. Data e saktë nuk më kujtohet e as mënyra e saktë nuk më kujtohet", ka thënë Çadraku. Ai ka thënë se Sokol Bashotën nuk e kishte njohur gjatë luftës dhe se pas saj e kishte kuptuar që ai ishte pjesë përbërëse e Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së. "Unë Sokol Bashotën nuk e kam njohur gjatë luftës. Atë që kam dëgjuar pas luftës ka qenë se ai ka qenë një pjesë përbërëse e Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së. Këtë po e them jo nga njohuritë e mia gjatë luftës me shokët e mi, por e kam mësuar pas luftës", tha Çadraku. Dëshmitari ka theksuar se gjatë kalimeve në Shqipëri ka mundur ta takojë edhe Hashim Thaçin, por që nuk e ka njohur në atë kohë e as funksionin e tij brenda UÇK-së. "Mund ta kem takuar Thaçin pa e ditur dhe pa e njohur se kush është dhe çfarë është brenda UÇK-së", ka thënë ai, duke treguar mënyrën se si e kishte takuar Thaçin në maj të '98-s. "Po, mendoj që ju kam treguar një insert të një udhëtimiti që ka qenë data 30 maji i vitit 1998, datë kjo kur në Kosovë nga Shqipëria kanë hyrë shtatë

eporët profesionistë të ish-Armatës Jugosllave. Më kujtohet që në atë udhëtim, një nga bashkëluftëtarët ka pasur nevojë për ndihmë se e vrau këmbën dhe e kemi ndihmuar duke ia marrë ato armatime nga krahu dhe më vonë, nuk e di kur e kam kuptuar që ka qenë Hashim Thaçi. Në atë udhëtim iu kam treguar se ka qenë edhe Adem Grabovci. Atë e njihja edhe nga viti '90. Kanë qenë, më duket, edhe Kadri Veseli edhe këta, por që ai person është Hashim Thaçi e kam mësuar më vonë", ka thënë Çadraku. Dëshmitari, gjithashtu, kishte thënë që "dhjetëshi", për të cilin kishte mësuar më vonë që ishte Rexhep Selimi, i kishte thënë atij që të shkonte në Rahovec që të takojë me Mensur Zymberin që njihet si "500"-shi. Ai ka thënë se nuk e dinte nëse Mensur Zymberi e njihje Thaçin në atë kohë, pasi asnjërin nga këta të dy nuk i njihje. "Mendoj se është e njëjta gjë si me Hashim Thaçin, si me Kadri Veselin në raport me Mensur Zymberin. Mendoj se kanë qenë në një gjeneratë dhe organizimi ka shkuar në bazë të besueshmërive dhe kjo të lë të kuptojë që ata i kanë besuar Mensurit në bazë të njohurive që kishin", ka thënë Çadraku. Dëshmitari ka thënë se Rexhep Selimin e kishte takuar edhe në dy raste, duke hyrë nga Shqipëria në Kosovë. "Mua më duket se e kam takuar Rexhep Selimin në një dy raste duke hyrë nga Shqipëria. Unë ju kam thënë se në Kosovë - Shqipëri kam udhëtuar mbi 35-36 herë në orientimin e grupeve për armatosje dhe njëherë e mbaj

mend që ishte qershori apo korriku dhe jemi nisur nga Shqipëria, përkatësisht nga Dobruna me një grup jo shumë të madh, por në atë grup mbaj mend që kanë qenë Rexhep Selimi dhe Xheladin Gashi-Plaku", i cili gjatë rrugëtimit është lodhur dhe pati nevojë për ndalim. Po, e mbaj mend që jemi takuar edhe gjatë rrugëtimitve Shqipëri - Kosovë, një, dy apo më shumë raste", ka thënë Çadraku. Po ashtu, Çadraku ka folur edhe për Ali Ahmetin, Bardhyl Mahmutin, LPK-në, formimin e partisë paraardhëse të PDK-së etj.

Çadraku: Kadri Veseli s'më ka zgjedhur mua në sektorin e ZKZ-së

Pas marrjes në pyetje nga prokuroria, dëshmitari Halil Çadraku është përgjigjur në pyetjet e avokatit të Kadri Veselit. Ai ka thënë se në pozitën e shefit të Zbulim-Kundërzbulimit (ZKZ) ishte emëruar nga komandant "Drini" (Ekrem Rexha) dhe jo nga Kadri Veseli. "Nga pjesa ime, unë kurrë nuk e kam parë Kadri Veselin që të flasë për mua me mua. Domethënë, nuk ka qenë Kadri Veseli ai që më ka përzgjedhur ose mua nuk më ka thënë 'Drini' diçka më tutje përpos që ai personalisht më ka përzgjedhur, duke u bazuar në fjalët e shumë ushtarëve aty përreth që më njihnin gjatë shkuarjeve e ardhjeve të mia në Shqipëri e Kosovë", ka thënë Çadraku. Përpara kësaj, dëshmitari ka thënë se

Çadraku: Thaçi është gjigant

Dëshmitari Halil Çadraku ka thënë në Hagë se që 25 vjet mendon se Hashim Thaçi është gjigant për shkak të drejtimit politik që i ka dhënë luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK). Ai këtë e ka thënë pasi i është paraqitur një video teksa dëgjohej në një intervistë televizive duke thënë se "Zoti lart, ndërsa Thaçi është poshtë", e që Kosova nuk do të ishte ajo që është sot pa të. "Kosova jonë, shteti ynë, me mileniume jemi të okupuar. Që tre mijë vjet dhe gjithmonë ka pasur luftëtarë. Kurrë Kosova s'ka pas mangët luftëtarë për të luftuar për atdhe. Lufta e fundit mendoj që ka qenë shumë mirë e orientuar falë drejtimit politik që ka ditur ta udhëheqë kjo strukturë politike në krye me Thaçin dhe shokët që kanë qenë jashtë si Xhavit Haliti, Bardhyl Mahmuti etj. Mendoj që Thaçi i ka meritat më të mëdha. Unë e falënderoj në emrin tim, të familjes sime dhe popullit për atë punë që ka bërë, sepse ishte një punë gjigante", ka thënë Çadraku. Ndërsa në një intervistë në

një emision televiziv, Çadraku ka thënë se shef i tij ishte Kadri Veseli deri më 1 prill 1999. Madje në një fotografi ku shihej Kadri Veseli, një person me nofkën "Hoxha", Mensur Zymberi, Adem Grabovci dhe vetë dëshmitari, ky i fundit kishte thënë se është bërë në Nishor në mars të '99-s, ku edhe ishin zhvilluar biseda që përfshinin nënshkrimin ose mosnënshkrimin e marrëveshjes së Rambujesë. I pyetur nga prokurori James Pace nëse ky informacion është i saktë, dëshmitari është përgjigjur "po". Përpara kësaj, Ismet Tarën, dëshmitari ka thënë se e njeh dhe se i njëjti ka qenë anëtar i UÇK-së. Ai ka thënë se asnjëherë nuk e ka vizituar shkollën e Shurdhmemecëve në Prizren gjatë vitit 1998-'99. Sipas tij, aty ka qenë e stacionuar Brigada 125, e udhëhequr nga Nehat Basha, kurse për Kimete Krasniqin dëshmitari ka thënë se e njeh nga paslufta dhe përafërsisht ka mundur ta takojë nga fillimi apo mesi i korriku kur ka shkuar në Prizren.

'Mos ia mbani anën prokurorisë', liderët e UÇK-së në Hagë u shkruajnë letër të ashpër gjyqtarëve të Speciales



HAGË, 26 NËNTOR - Një letër sikur asnjëherë më parë ka shkuar në adresën e gjyqtarëve të Gjykatës Speciale në Hagë, në rastin e liderëve të UÇK-së.

Mbrojtja e Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Jakup Krasniqit dhe Rexhep Selimit, në emër të katërshes së Ushtrisë Çlirimtare e Kosovës (UÇK), kanë kërkuar nga gjyqtarët e rastit të mos ia mbajnë anën prokurorisë, por të jenë të paanshëm në zbardhjen e së vërtetës.

Pyetjet e gjyqtarëve ndaj dëshmitarëve në rastin e krerëve të UÇK-së kanë alarmuar avokatët e Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit e Jakup Krasniqit. Me një letër të unifikuar, mbrojtja e ish-eporëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës ka ngritur alarmin, duke kërkuar nga gjyqtarët e rastit të mos ia mbajnë anën prokurorisë.

Në letër në cilën e ka publikuar "Nacionale" është thënë se pyetjet e gjyqtarëve po e shtyjnë përpara rastin e prokurorisë dhe nuk po e sfidojnë të vërtetën. Sipas avokatëve, ata po paragjykojnë nga gjyqtarët e rastit. "Është thelbësore që trupi gjykues jo vetëm që duhet të ushtrojë funksionet e tij në mënyrë të paanshme, por duhet të sigurojë edhe shfaqjen e paanshmërisë. Marrja gjyqësore e pakufizuar në pyetje e dëshmitarëve, gjatë gjithë këtyre procedurave dhe veçanërisht gjatë bllokut të provave 21 tetor 2024 - 7 nëntor 2024, është duke rrezikuar shfaqjen e paanshmërisë në këto procedura dhe duke shkaktuar paragjykim të identifikueshëm për mbrojtjen. Siç shpjegohet më

poshtë, marrja në pyetje nga gjyqtarët po çon përpara çështjen e prokurorisë ose një çështje gjyqësore të ngjashme me të, duke marrë rolin që normalisht do të luante Prokuroria dhe duke dështuar në sqarimin ose eksplorimin e ndonjë informacioni shfaqësues. Mbrojtja e Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit kërkon nga trupi gjykues që të ndërmarrë hapa për të siguruar pamjen e paanshmërisë dhe për të kufizuar paragjykimet ndaj mbrojtjes gjatë marrjes në pyetje gjyqësore", është thënë në parashtrësën e mbrojtjes së liderëve të UÇK-së.

Mbrojtja ka përmendur shqetësimet e mëhershme që kanë pasur në këtë temë, duke theksuar edhe pranimin e disa dokumenteve të cilat ishin përdorur gjatë marrjes në pyetje nga gjyqtarët. Sipas avokatëve, fakti që dokumentet që u nxorën gjatë pyetjeve të gjyqtarëve u pranuan si prova, tregon se ka mungesë të paanshmërisë. Madje, me një vendim të korrikut 2024, gjyqtarët vendosën se nuk lejohen kundërshtime gjatë pyetjeve të gjyqtarëve.

Mbrojtja e liderëve të UÇK-së ka përmendur dokumentet e konventat ndërkombëtare të cilat prezantojnë rolin e gjyqtarëve, dhe elementeve që duhet të përfshijnë ata gjatë intervistimit, duke sfiduar rastin e Prokurorisë.

Sipas avokatëve, në shumë raste gjyqtarët kanë bërë më shumë pyetje se vetë mbrojtja. "Me respekt parashtrëhet se tani kërkojnë masa për të siguruar paraqitjen e paanshmërisë në

procedurë dhe për të shmangur paragjykimet e pariparueshme ndaj mbrojtjes. Ndikimi i pyetjeve gjyqësore është i dukshëm nga raportet periodike kohore të përgatitura nga Zyra e Regjistrimit. Deri më 11 nëntor 2024, marrja në pyetje nga gjyqtarët kishte zgjatur 71 orë 36 minuta e 34 sekonda. Kjo përbën 13 ditë kohë gjyqësore, më shumë se një bllok të tërë provash, edhe pa marrë parasysh kohën e nevojshme për marrje në pyetje shtesë pas marrjes në pyetje gjyqësore. Koha e përdorur për marrjen në pyetje gjyqësore tejkalon kohën e përdorur nga tre nga katër ekipet e mbrojtjes. Sido që të jetë, koha që i kushtohet pyetjeve gjyqësore është shumë e konsiderueshme dhe po ndikon në zhvillimin e shpejtë të këtyre procedimeve. Kjo është befasisëse pasi çdo boshllëk në prova duhet të adresohet nga palët përmes rishqyrtimit, ndërsa pyetja gjyqësore, e cila zakonisht është për të sqaruar aspektet e provave, nuk duhet të zgjasë më shumë se ajo e një pale në procedurë", është thënë në këtë parashtrësë, duke përmendur edhe kohën që ka mbrojtja në dispozicion në raport me prokurorinë. "Megjithatë, më shqetësuese se koha e marrë është mënyra në të cilën kjo pyetje gjyqësore do të perceptohej nga çdo shikues i arsyeshëm. Kjo gjithashtu mund të matet nga raportet periodike kohore. Që nga 11 nëntori 2024, mbrojtja kërkoi kolektivisht 31 orë e 23 minuta për pyetje të mëtejshme pas marrjes në pyetje gjyqësore; prokuroria ka shfrytëzuar 12 minuta. Prandaj, mbrojtjes i është dashur të përdorë më shumë se 100 herë më shumë

se sa kohë për marrjen në pyetje të Prokurorisë. Pabarazia e madhe në këto shifra e bën të qartë marrjen në pyetje nga gjyqtarët. Qartë, perceptimi i mbrojtjes ka qenë se ka pasur nevojë për t'iu përgjigjur pyetjeve gjyqësore, ndërsa perceptimi i Prokurorisë është se nuk ka pasur nevojë të tillë", është thënë në parashtrësën e tyre.

Avokatët kanë alarmuar se bazuar në këto statistika, dëshmohej se për Prokurorinë, pyetjet e gjyqtarëve nuk janë sfiduese. Si rezultat, kanë aluduar se del që gjyqtarët po ia mbajnë anën Prokurorisë së Specializuar në Hagë. "Për më tepër, këto statistika tregojnë se prokuroria nuk i percepton pyetjet e gjyqtarëve si sfiduese të çështjes së prokurorisë në asnjë mënyrë, ndërsa mbrojtja në masë dërmuese i percepton pyetjet e gjyqtarëve që cenojnë prezumimin e pafajësisë së të akuzuarit. Ky çekuilibër bruto është në kundërshtim me të drejtën themelore të të akuzuarit për një gjykatë të pavarur dhe të paanshme, si dhe me detyrimin etik të çdo anëtari të Panelit jo vetëm që të jetë subjektivisht i paanshëm kur bën pyetje, por edhe të jetë me mirëbesim", është thënë në këtë parashtrësë.

Si asnjëherë më parë, gjuha e avokatëve ka qenë e ashpër. Ata e kanë akuzuar direkt trupin gjykues se nuk po e sfidon rastin e prokurorisë, madje nuk po e respekton as prezumimin e pafajësisë. "Marrja në pyetje gjyqësore po krijon përshtypjen se Paneli nuk e sfidon rastin e Prokurorisë, por përkundrazi po përdor pjesën më të madhe të

kohës dhe po e drejton shumicën e pyetjeve të tij drejt temave fajësuese, duke krijuar përshtypjen e qartë se prezumimi i pafajësisë së të akuzuarit nuk është duke u respektuar. Mënyra dërmuese e njëanshme në të cilën është kryer marrja në pyetje gjyqësore në këtë gjykim ka krijuar vetë 'kuptimin e njëanshmërisë' që Kolegji i Apelit e citoi shprehimisht si kufizim në marrjen në pyetje gjyqësore, dhe ka shkelur të drejtat e të akuzuarit për një të pavarur dhe gjykata e paanshme. Të katër të akuzuarit shënojnë zyrtarisht kundërshtimin e tyre ndaj mënyrës në të cilën është kryer marrja në pyetje gjyqësore gjatë gjithë këtij gjykimi dhe pohojnë se të drejtat e tyre për gjykim të drejtë dhe e drejta për një gjykatë të pavarur dhe të paanshme janë shkelur", është thënë në parashtrësën e mbrojtjes së liderëve të UÇK-së.

Më tutje janë paraqitur kërkesat direkte që ka pasur secili i akuzuar ndaj gjyqtarëve. "Të akuzuarit me respekt kërkon që Paneli t'i marrë parasysh këto kundërshtime dhe të ndërmarrë të gjitha hapat e nevojshëm për të siguruar që secili anëtar i Panelit jo vetëm që do të veprojë në mënyrë të paanshme, por do të bëjë përpjekje të mirëbesimit për të krijuar pamjen e paanshmërisë në mënyrën në të cilën ata kryerja e pyetjeve gjyqësore. Hapat e tillë duhet të përfshijnë: Bërja e pyetjeve që sfidojnë rastin e Prokurorisë", është thënë në këtë parashtrësë.

Në këtë pjesë janë përmendur edhe pyetjet orientuese. "Kërkojnë kufizimin e praktikës së sugjerimit të përgjigjeve për dëshmitarët, duke përfshirë parathënien e pyetjeve me paralajmërimin, 'Unë nuk dua të vendos fjalë në gojën tënde' dhe më pas të vazhdojë të vendosësh fjalë në gojën e një dëshmitari. Është jashtëzakonisht e rrezikshme për gjyqtarët që t'i sugjerojnë dëshmitarëve duke pasur parasysh se dëshmitarët në mënyrë të pashmangshme prirën t'i shohin gjyqtarët si autoritete, sugjerimet e të cilëve duhen ndjekur; Shmangia e përdorimit të marrjes në pyetje gjyqësore si mjet për nxjerrjen e provave kundër të akuzuarit që është përtej fushëveprimit të shqyrtimit të drejtpërdrejtë të prokurorisë", është thënë në parashtrësë.

Pikërisht për këtë temë ishte pyetur kryetarja e Gjykatës Speciale në një konferencë për medie pak ditë më parë. Ekaterina Trendafilova e ka pranuar se pyetjet orientuese janë të ndaluara, megjithatë ajo ka thënë se nuk ka për pyetje të tilla në gjykimin e krerëve të UÇK-së. Pasi ajo është sfiduar me raste konkrete, ajo ka kërkuar t'i shohë me video kur ta vizitojë Kosovën.

FSK-ja përfundon ushtrimin fushor në qitje dhe manovra me municion luftarak

PRISHTINË, 26 NËNTOR - Në kuadër të ngritjes së kapaciteteve të këmbësorisë, Kompania 1B e Regjimentit të Parë të Këmbësorisë së

FSK-së ka realizuar ushtrimin fushor "IRON BRAVO 2024". "Ushtrimi kishte për qëllim përfundimin e qitjeve dhe

manovrave me municion luftarak në nivel kompanie, ndërsa detyrë esenciale në të cilën është trajnuar kjo kompani ishte mbrojtja

zonale (operacionet mbrojtëse) si dhe detyrat kyçe kolektive të cilat mbështesin atë", ka njoftuar FSK-ja.



Kryetari Konjufca në fushatën kundër dhunës me bazë gjinore: Është i domosdoshëm solidarizimi i vazhdueshëm dhe angazhimi i përditshëm

EPOKA ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 26 NËNTOR - Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca, mori pjesë dhe mbajti fjalë në Konferencën "Të Bashkuar Kundër Dhunës - Mjaft!", të organizuar nga Ministria e Drejtësisë dhe Koordinatorja Nacionale Kundër Dhunës në Familje dhe Dhunës me Bazë Gjinore, në kuadër të fushatës globale të 16 ditëve të aktivizimit kundër dhunës me bazë gjinore.

Në fjalën e tij para të pranishmëve, kryeparlamentari Konjufca tha se kjo fushatë është dëshmi se në përpjekjet për ta luftuar dhunën në familje dhe dhunën me bazë gjinore, është i domosdoshëm solidarizimi i vazhdueshëm dhe angazhimi i përditshëm. Dhuna gjinore sipas kreut të

Kuvendit, fatkeqësisht, mbetet një problem i madh, dhe ndonëse janë bërë hapa domethënës për avancimin e kuadrit ligjor dhe ngritjen e ndërgjegjësisë, ende ka shumë punë për të bërë.

Kryetari Konjufca tha se nëpërmjet përmirësimit të legjislacionit ekzistues, janë krijuar mekanizma të qëndrueshëm për mbrojtjen e të mbijetuarve të dhunës, ndërsa institucionet tona janë më të përgatitura tash për t'iu përgjigjur nevojave të viktimave të dhunës. "Siç e dini, Kuvendi i Republikës së Kosovës vitin e kaluar ka hartuar dhe miratuar nismën ligjore për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna në Baza Gjinore, dhe këtë jemi përpjekur ta harmonizojmë me Konventën e Stambollit. Ligji



njeh lloje të ndryshme të dhunës, duke përfshirë lëndimin fizik, seksual, psikologjik ose ekonomik, por edhe dhunën ndaj grave në politikë, ngacmimet e ndryshme si dhe ngacmimet seksuale në internet", theksoi

Konjufca. Në vazhdim të fjalës së tij i pari i Kuvendit tha se, përkundër të gjitha këtyre masave ligjore dhe institucionale, edhe plot fushatave të tjera vetëdijesuese që kanë ndodhur dhe po ndodhin, progresi nuk është i

kënaqshëm, përderisa rastet e dhunës ndaj grave nuk është që kanë pësuar rënie të ndjeshme. "Kjo na bën të mendojmë që nevojitet një qasje holistike ndaj këtij fenomeni, një strategji e gjerë që trajton të gjitha aspektet dhe faktorët që direkt apo indirekt ndërlidhen me këtë problematikë", theksoi kryeparlamentari Konjufca, duke bërë thirrje për fokusim në zhvillimin e një edukimi të hershëm që promovon vlera të barazisë dhe respektit. Kryetari i Kuvendit të Kosovës tha se ky fenomen nuk mund të luftohet vetëm me mekanizma institucionale, pra nuk janë të mjaftueshëm, por kjo është përgjegjësi e jona e përbashkët. "Secili prej nesh ka për obligim që të angazhohet dhe të punojë për një shoqëri të barabartë dhe pa dhunë", tha kryetari Glauk Konjufca.

Haradinaj: Më 9 shkurt duhet të ndalet trendi i humbjeve

PRISHTINË, 26 NËNTOR - Kryetari i AAK-së, Ramush Haradinaj, ka thënë se të mëdha dhe disa mbase të pariparueshme janë humbjet e Kosovës në katër vitet e fundit. Sipas tij, orientimi strategjik krejtësisht i gabuar i Kurtit dhe qeverisë bëri që Kosova ta humbë kërkesën e vendeve aleate për marrëveshje gjithëpërfshirëse me Serbinë dhe njohje reciproke, Kosova humbi të gjitha shanset për përafrim dhe anëtarësim në NATO, Kosova humbi shansin që të jetë anëtare e Këshillit të Evropës, Kosova humbi Contour Global dhe investimin prej 1.5 miliardësh në ndërtimin e kapaciteteve të reja energjetike dhe e humbi edhe rastin gjyqësor, Kosova e humbi projektin e gazit amerikan, një shans për siguri energjetike afatgjatë nga miqtë më të mëdhenj që ka Kosova, Qeveria e Kosovës humbi besimin e 200 mijë qytetarëve të vet të cilët braktisën



Kosovën për jetë më të mirë, dhe Kosova, për fitore optike dhe tepër afatshkurtra në komunat veriore, humbi besimin dhe përkrahjen e

vendeve aleate dhe e cenoi gjithë projektin e përbashkët të Kosovës me aleatët. "E gjatë është lista e humbjeve dhe frika se vazhdimi i kësaj

qeverisjeje do t'i rrisë dhe rëndojë humbjet e Kosovës. Më 9 shkurt duhet të ndalet trendi i humbjeve. Ka ardhur koha për ta shndërruar

Kosovën në fituese. Ne të gjithë e kemi për obligim të punojmë për një Kosovë fituese: Për një Kosovë fituese në aspiratat për anëtarësim direkt në NATO; Për një Kosovë fituese në zhvillim; Për një Kosovë fituese në lobim për njohje dhe respekt ndërkombëtar; Për një Kosovë fituese në dialog dhe në marrëdhënie ndërkombëtare dhe për një Kosovë fituese nga burimet e saj njerëzore dhe natyrore. Kosova nuk duron më humbje. Kosova nuk duron qeveri që humbjet i mbulon me demagogji dhe propagandë", është shprehur Haradinaj në një deklaratë në "Facebook", duke shtuar se Kosova nuk duron mashtrues që humbjet i quan fitore. "Ne duam t'u kthehemi fitoreve. Fitoreve tona, qoftë si individë, qoftë si shoqëri. Për një Kosovë fituese e kemi obligim të gjithë të angazhohemi e të punojmë", ka deklaruar Haradinaj.

Përfundoi renovimi i hapësirave të brendshme të QMF-së në Krushë të Madhe

RAHOVEC, 26 NËNTOR - Kryetari i komunës së Rahovecit, Smajl Latifi, së bashku me drejtoreshën e Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje

Sociale, Saranda Sallteku dhe bashkëpunëtorë, në praninë e stafit shëndetësor, ka vizituar hapësirat e brendshme të rinovuara të QMF-së në

Krushë të Madhe. "QMF-ja në Krushë të Madhe, tashmë, i plotëson të gjitha kushtet infrastrukturorë, sipas të gjitha standardeve, ndërsa

profesionistët shëndetësorë do të kenë kushte të favorshme për të ofruar shërbime sa më cilësore", ka thënë kryetari Latifi.



Pasivizimi i adresave në Luginë, drejt Gjykatës së Strasburgut

PRISHTINË, 26 NËNTOR - Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut në Strasburg do të jetë adresa e radhës ku do të drejtohet Safet Demiri nga fshati Banjë e Sijarinës në jug të Serbisë. Ai pretendon se autoritetet e këtij vendi ia kanë pasivizuar pa të drejtë adresën në këtë fshat të Medvegjës qysh në vitin 2019. Për plot pesë vjet ai iu drejtua instancave të ndryshme gjyqësore në Serbi, derisa Gjykata Kushtetuese e vendit ia hodhi poshtë ankesën në mes të këtij muaji. Rasti i tij nxiti reagimin e autoriteteve në Kosovë, por edhe në Bashkimin Evropian.

Pasivizimi i adresave në Serbi

Pasivizimi i adresave, që nënkupton fshirjen e qytetarëve nga adresat ku kanë qenë të regjistruar, përcaktohet me ligj në Serbi qysh në vitin 2011. Në bazë të tij, policia i bën tri kontrole për të kuptuar nëse një banor jeton në adresën e regjistruar. Në rast se ai nuk haset aty, adresa i pasivizohet.

Pasivizimi rezulton, pastaj, me humbjen e shtetësisë serbe, rrjedhimisht të të gjitha të drejtave civile, përfshirë atë për të votuar, për të pasur pronë, për të pasur sigurim shëndetësor e pension dhe për t'u punësuar.

Shumica shqiptare që jeton në komunat në jug të Serbisë - Preshevë, Bujanoc e Medvegjë, të njohura si Lugina e Preshevës - ankohet prej vitesh për pasivizimin e adresave.

Çështja u përmend edhe në Raportin e sivjetmë të Progresit për Serbinë, të hartuar nga BE-ja, si dhe në raportin e Departamentit Amerikan të Shtetit për të drejtat e njeriut në Serbi për vitin 2023.

Rasti i Safet Demirit

“Unë jam banor vendas. Nuk kam ardhur turist”, thotë Demiri për “Radion Evropa e Lirë”. Ai tregon se prej vitesh jeton dhe punon midis Austrisë dhe Serbisë.

Në Medvegjë, ku jetojnë prindërit e tij, thotë se ka të regjistruar një kompani telekomunikimi, ndërsa në Vjenë punon në ndërtim.

Adresa e tij në vendlindje është e pasivizuar qysh në vitin 2019. “Ata [autoritetet] vetëm kanë thënë se unë nuk banoj aty. Ata nuk i kanë verifikuar dokumentet e mia, që i kam pronat, kam tokë aty, kam lindur aty”, shprehet 46-vjeçari.

Ai thotë se ka dëshmi që tregojnë se në ditën kur autoritetet serbe pretendojnë se e kanë vizituar adresën e tij dhe nuk e kanë gjetur, ai ka qenë në stacion policor për të marrë një dokument.

Shprehet i bindur se autoritetet serbe nuk e kanë vizituar adresën e tij, siç parashihet në ligj. “Unë e kam të gjithë ndërtesën e mbuluar nga kamerat. Nënën dhe babanë i kam aty. Ata jetojnë aty 24 orë. Askush nuk ka qenë”, thotë Demiri.

Ai iu drejtua disa gjykatave në Serbi, të cilat ia refuzuan ankesën me arsyetimin se jeton jashtë vendit.

Më 14 nëntor Gjykata Kushtetuese e Serbisë - institucioni i fundit ku u ankua - ia refuzoi kërkesën për vërtetimin e fakteve.

Fatin e Demirit behohet se e ndajnë edhe mijëra njerëz të tjerë që jetojnë në komunat me shumicë shqiptare në Serbi.

Disa herë këtë vit ata protestuan kundër pasivizimit të adresave për njohje të diplomave të Kosovës, për integrim në institucionet shtetërore të Serbisë e të tjera.

I pyetur nga gazetarët se si i komenton këto pakënaqësi, presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq, tha se “askush nuk po i rrah, nuk po i ngacmon, apo diçka tjetër. Serbia është shtet demokratik dhe ne do të vazhdojmë të sillemi në këtë mënyrë”.

Demiri thotë se adresë të radhës tani do ta ketë Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut në Strasburg.

Këtë e konfirmon për “Radion Evropa e Lirë” edhe avokati i tij, Aleksandar Olenik. “Do ta dërgojmë [ankesën] në dy



muajt e ardhshëm. Zyra ime për aq kohë do ta përgatisë. Se sa do të zgjasë atje [në Gjykatën e Strasburgut] dhe kur do të nisë procedura [gjyqësore] nuk e di”, thotë Olenik, duke shtuar se ky do të jetë rasti i parë për këtë çështje që do të dalë para gjykatës evropiane.

Cilat janë gjasat e Demirit në Gjykatën e Strasburgut?

Dukagjin Leka, profesor i së Drejtës Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut në Universitetin “Haxhi Zeka” në Gjiçan, thotë se pas refuzimit të ankesës së Demirit nga Gjykata Kushtetuese e Serbisë, ai i ka gjashtë muaj kohë ta parashtrijë rastin në Gjykatën e Strasburgut. “Unë mendoj se pala në këtë rast, shqiptar në Serbi, me humbjen e adresës privohet nga një e drejtë elementare. Në këtë rast është shkelur Konventa [Evropiane për të Drejtat e Njeriut]. Mendoj se përfundimi i procesit gjyqësor në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut do të jetë pozitiv për personin që do ta dërgojë rastin atje”, thotë Leka për “Radion Evropa e Lirë”.

Vendimi në favor të Demirit do të reflektohet, sipas tij, edhe në rastet e personave të tjerë, të cilëve, ngjashëm, u janë pasivizuar adresat në Serbi. Avokati Olenik shprehet, po ashtu, për një vendim në favor të Demirit nga Gjykata e Strasburgut. Por, nuk beson se rasti i tij do të shërbente si

precedent gjyqësor për rastet e tjera të ngjashme. “Sipas ligjit tonë [në Serbi], por edhe sipas ligjeve tuaja në Kosovë, ne nuk kemi sistem juridik të precedentëve, që një aktgjykim t'i obligojë edhe gjykatat e tjera në procedurat e njëjta apo të ngjashme. Megjithatë, praktika gjyqësore ka një loj ndikimi”, thotë Olenik.

Për të, çështja e pasivizimit të adresave në Serbi nuk është aspak ligjore, por politike dhe ka në shënjestër vetëm komunitetin shqiptar. “Pasivizimi i adresave ekziston vetëm në jug të Serbisë dhe vetëm për shqiptarët. Në veri, në Vojvodinë, ku jetojnë hungarezët, kroatët, në Sanxhak ku jetojnë boshnjakët, nuk ka pasivizim të adresave”, sipas avokatit Olenik.

Pse pasivizohen adresat?

Autoritetet e Ministrisë së Brendshme në Serbi nuk iu përgjigjën kërkesave të njëpasnjëshme të Radios Evropa e Lirë për komente.

Në raportin e Komitetit të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut në Serbi, të vitit 2021, Presheva, Medvegja dhe Bujanoci përshkruhen si pengje të marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Sipas raportit, çështja e pasivizimit të adresave “në thelb është formë e spastrimit etnik nëpërmjet metodave administrative”.

Duke folur për “Radion Evropa e Lirë”, deputeti i vetëm shqiptar në Kuvendin e

Serbisë, Shaip Kamberi, thotë se pasivizimi i adresave bëhet me urdhrin e autoriteteve serbe. Ai vlerëson se deri më tash nuk ka ndonjë iniciativë serioze nga institucionet ndërkombëtare për t'ia bërë me dije Serbisë që ta ndërpresë praktikën e pasivizimit të adresave të shqiptarëve në Luginë. Sipas tij, ka shumë familje, adresat e të cilave janë pasivizuar dhe nuk kanë mundësi financiare të ushtrojnë padi në Gjykatën e Strasburgut.

Por, ai shton se në këtë pikë mund të ndihmojë faktori politik që i përfaqëson shqiptarët e këtij rajoni, duke krijuar një fond të veçantë për t'i ndihmuar ata që duan ta realizojnë të drejtën e tyre në Gjykatën e Strasburgut. “Jo vetëm të llojmë, por edhe të ndihmojmë, qoftë me gjetjen e avokatëve, qoftë me ndihmë financiare që ky proces të shkojë përpara”, thotë Kamberi. Se sa adresa janë pasivizuar saktësisht, nuk ka të dhëna.

Sipas regjistrimit të fundit të popullsisë më 2022, në Serbi jetojnë më shumë se 60 000 shqiptarë, duke përbërë pakicën e katërt më të madhe atje.

Shqiptarët e bojkotuan regjistrimin paraprak më 2011, për shkak të, siç u tha atëkohë, obligimeve të paplotësuara të shtetit serb ndaj tyre dhe kushteve diskriminuese.

Belgim Kamberi, nga Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut në Preshevë, thotë se pasivizimi i adresave “e ka lënduar edhe procesin e integritetit të shqiptarëve, i cili ka nisur në vitin 2001, me përkrahjen e bashkësisë ndërkombëtare”.

Pas riaktualizimit të çështjes me rastin Demiri, javën e kaluar, presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, kërkoi nga bashkësia ndërkombëtare t'i bëjë trysni Serbisë për t'i respektuar të drejtat e shqiptarëve në jug të vendit.

Në Bashkimin Evropian thanë se janë në dijeni për shqetësimet e shqiptarëve në jug të Serbisë dhe se janë duke i ndjekur nga afër këto zhvillime.

QKUK rikthen shërbimin ESWL për trajtimin e gurëve në veshka me standardet më moderne

PRISHTINË, 26 NËNTOR - Klinika e Urologjisë në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës (QKUK) ka rikthyer shërbimin e rëndësishëm për trajtimin e gurëve në veshka dhe sistemin urinar ESWL (Extracorporeal Shock Wave Lithotripsy).

Ky shërbim ka qenë jashtë funksionit për një periudhë kohore, por tani është rikthyer në një hapësirë të rinovuar, duke ofruar standarde të reja dhe kushte moderne për pacientët.

Për ta përmirësuar efikasitetin dhe qasjen për qytetarët orari i shërbimit është zgjatuar, duke mundësuar trajtime në dy ndërrime. Ky ndryshim synon t'i përshpejtojë procedurat dhe ta shkurtojë kohën e pritjes për pacientët që kanë nevojë për këtë trajtim.

Aparatura për ESWL është vendosur jashtë sallave operative, një masë që është marrë për t'i shmangur rreziqet e infeksioneve dhe për të siguruar kushte më të sigurta

gjatë procedurave. Ky organizim tregon përkushtimin e QKUK-së për ta rritur cilësinë e shërbimeve dhe për të ofruar kujdes shëndetësor më cilësor për qytetarët.

Rikthimi i shërbimit ESWL është një hap tjetër drejt avancimit të shërbimeve shëndetësore në Kosovë, duke reflektuar përkushtimin për modernizimin e kujdesit ndaj qytetarëve dhe përmirësimin e vazhdueshëm të infrastrukturës mjekësore.



Lansohet pulla postare "Sot dhe çdo ditë tjetër"

Prishtinë, 26 nëntor - Ministri e Ekonomisë, Artane Rizvanolli, ka marrë pjesë në aktivitetin e fushatës ndërkombëtare "16 ditët e aktivizimit kundër dhunës me bazë gjinore", ku u lansua pulla postare "Sot dhe çdo ditë tjetër". Në këtë aktivitet, përveç ministres Rizvanolli, kanë marrë pjesë edhe ministrija e Drejtësisë, Albulena

Haxhiu, kryeshefja e Postës së Kosovës, Nora Rraci, anëtarë të Komisionit për Pullat Postare si dhe të pranishëm të tjerë. Kjo ngjarje është organizuar në kuadër të fushatës ndërkombëtare "16 ditët e aktivizimit kundër dhunës me bazë gjinore", ku bëhet thirrje kundër dhunës ndaj grave, e cila mbahet nga 25 nëntori deri më 10 dhjetor në gjithë botën. Në

aktivitetin e mbajtur sot është lansuar pulla postare "Sot dhe çdo ditë tjetër" që vjen edhe si vazhdimësi e shërbimeve të modernizuara të Postës së Kosovës. Kjo fushatë organizohet nga Ministria e Drejtësisë për tri vjet me radhë, ku për gjatë 16 ditë do të ketë aktivitete të ndryshme, që bëjnë thirrje kundër dhunës në baza gjinore.



Konventa e Drurit, Kurti: Kosova po e gdhend një vend të veçantë në tregun global



EPOKA E RE **Qendresa RAMA**

Prishtinë, 26 nëntor - Kryeministri Albin Kurti mori pjesë në ceremoninë hapëse të edicionit të 7-të të Konventës së Drurit organizuar nga Shoqata e Përpunuesve të Drurit të Kosovës, e cila këtë vit shënon 20-vjetorin e saj. Para të pranishmëve, në fjalën e tij hyrëse, kryeministri Kurti tha se industria jonë e përpunimit të drurit ka parë rritje mbresëlënëse, ku eksportet vetëm në tretremujorin e parë të

këtij viti kanë arritur nivelin total të vitit të kaluar. "Ne kemi rreth 1 000 kampionë të mobilerisë, që formësojnë aktivisht këtë sektor, një dëshmi e përkushtimit, produktivitetit dhe krijimtariisë së tyre. Zvicra kryeson si destinacioni kryesor për eksportet tona të mobileve, e ndjekur nga Gjermania. Pra, me plot gojë mund të themi se Kosova po e gdhend një vend të veçantë në tregun global", u shpreh kryeministri Kurti. Ai tha se si shtet aspirojmë të jemi më të mirët në Ballkanin Perëndimor jo vetëm në

demokraci, sundim të ligjit, pluralizëm politik, të drejta të njeriut, rritje të brutoproduktit vendor dhe shifra tregtare, por edhe në kultivimin e një fryme të inovacionit e të bashkëpunimit. Duke përmendur faktin se industria e përpunimit të drurit në Kosovë po fiton vëmendje të madhe, kryeministri zuri ngoje disa faktorë të rëndësishëm, si vendndodhjen strategjike, potencialin bashkëpunues, si dhe talent krijues, faktorë këta të cilët japin mundësi për zgjerim të investimeve në këtë

sektor. "Gjithashtu, edhe marrëveshja jonë e Tregtisë së Lirë me vendet e EFTA-s e forcon më tej pozicionin tonë, duke hapur dyert që Kosova të luajë një rol qendror në tregjet rajonale dhe globale", tha ai. Kurti tha se strategjia jonë kombëtare për zhvillimin e këtij sektori (të drurit) e ka mbështetjen e plotë të secilës ministri, jo vetëm thjesht të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, po të secilës ministri, të secilës drejtori edhe të tijen si kryeministër. "Tek i cili nuk

duhet ta shihni vetëm dikë që garanton me sundim të ligjit konkurrencën e lirë dhe fer, gjithashtu edhe bashkëpunimin e partneritetin si një infrastrukturë politike e institucionale për rritjen tuaj biznesore dhe ekonomike", deklaroi kryeministri Kurti. Në përfundim të fjalës së tij, ai tha se shkathtësia për të ndryshuar, qëndrueshmëria dhe inovacioni - janë thelbi i identitetit tonë. Këto vlera e bëjnë Kosovën vendin e duhur për të investuar, bashkëpunuar dhe për t'u rritur.

Peci: Gratë e Krushës i subvencionuam me mbi 1 milion e 900 mijë euro

Prishtinë, 26 nëntor - Ministri i Bujqësisë, Faton Peci, ka bërë me dije se gjatë këtij mandati kanë mbështetur 30 gra të Krushës

me 1 milion e 933 mijë e 327 euro përmes subvencioneve dhe granteve. "Brenda mandatit tonë qeverisës, 1,933,327.85 euro është vlera

e mbështetjes financiare me të cilën janë përkrahur 30 gra në mesin e shumë përfituesve, fermerë të Krushës

subvencioneve dhe granteve. Për tokën e larë me gjak të Krushës, për tokën e begatë të Kosovës!", ka shkruar ministri Peci në "Facebook".



“The Godfather”, një kryevepër e brutalitetit dhe poezisë

Nga Eusebio CICCOTTI

Për herë të parë mafia po u tregohej njerëzve me një seriozitet historik dhe antropologjik.

Për herë të parë aspekti njerëzor i mafiozitetit e bëri këtë të fundit një hero “pozitiv”. Skenat e dhunës brutale altermoheshin me momente poezie, duke e trazuar psikikën e spektatorit, dhe duke konkurruar me përsosmërinë stilistike.

Kjo ishte tronditja që shkaktoi dalja në kinema e filmit “The Godfather” (Kumbari) në vitin 1972 me regjinë e Francis Ford Coppola, dhe skenar të Mario Puzo, bazuar në romanin e njohur me të njëjtin titull, botuar për herë të parë në vitin 1969.

Të gjithë e mbajnë mend fillimin e filmit me siçilianin Bonasera (Salvatore Corsitto) që i kërkon Don Vito Corleones (i interpretuar nga një Marlon Brando tejet i zhytur në të thella), për të vrarë 2 të rinj amerikanë, që ishin fajtorë për çnderimin e vajzës së tij.

Vito e kundërshtoi duke i thënë se ai ka qenë gjithmonë asnjë, se nuk ka pranuar mbrojtje në të kaluarën, dhe tani “ti më kërkon të vras 2 njerëz, dhe nuk më quan as “Kumbar”.

Bonasera e kupton situatën, ulet në gjunjë i puth dorën dhe e thërret “Kumbar”, si një rit besnikërie dhe nënshtrimi. Ajo skenë zhvillohet e gjitha nën dritën e zbehtë të studios së DonVitos, dhe dëshmitarë ishin vetëm bashkëpunëtorët e tij më të afërt. Në atë ditë të vitit 1946, po kremtohej në kopshtin e madh të shtëpisë dasma e së bijës.

Tonalitetet e gjysmë errësirës në atë skenë justifikohen objektivisht nga drita verbuese e një dite vere që vjen nga jashtë. Por në fakt, Francis Ford Coppola shtoi enkas tonalitetet e errëta për arsye semantike. Ai i kërkonte drejtorit të fotografisë, Gordon Willis, të shmangë reflektimin e dritave të brendshme në bebëzat e syve të protagonistëve, për t'i bërë fytyrat e tyre më dramatike, më të ngurta dhe pa emocione. Simpatia e spektatorin për “mafiozin” në filmin “Kumbari” lind kur djali më i vogël i DonVitos, Michael (Al Pacino, që interpreton një vrasës-filozof me fytyrë intelektuale), u rikthye në shtëpi i dekoruar nga lufta dhe u fejua me May (interpretuar nga Diane Keaton), edhe pse nuk kishte lidhje me aferat kriminale të familjes, detyrohet që të marrë pjesë në to. Në fakt Don Vito synonte ta mbante atë “jashtë



biznesit familjar. Por kur bie pre e një atentati që gati i mori jetën të kryer nga familjet rivale mafioze në Nju Jork, i riu Michael e gjen veten në qendër të botës së kriminit.

Për të gjithë fillon kur rastësisht shkon në spital për të vizituar të atin, që ishte shtruar atje pas atentatit. Çuditërisht, spitali ishte i shkretë, i gjithë stafi kishte ikur. Infermierët kishin lënë bukën në mes. Në hyrje nuk kishte asnjë polic.

Edhe pse ende jo një mafioz, si një oficer i dekoruar i ushtrisë Michael e kupton, se pacienti është lënë qëllimisht vetëm. Ai i kërkon infermierës së vetme që ndodhej në spital që ta ndihmojë: “Ti e di kush është babai im. Ata po vijnë që ta vrasin. Ju lutem më ndihmoni ta çoj në një dhomë tjetër”.

Michael dhe infermierja e shtynë shtratin përmes një korridorit derisa sa mbërrin në një bodrum. Më pas, aty shfaqet një i njohur i babait të tij, luleshitësi i lagjes, që mbante në dorë një buqetë me lule. Michael e dërgon në shkallët e spitalit, përpara derës së përparme të godinës. Pasi e fshehur të atin, Michael i bashkohet luleshitësit duke pozuar si një mafioz.

Ai ngre jakën e palltos, dhe e fut dorën në njërën anë të gjoksit, si për të lënë të kuptohet se është i armatosur. Michael bën të njëjtën gjë. Është një leksion i vërtetë regjisure. Pak sekonda më vonë para spitalit mbërrin një krye-mafioz.

Ata i shohin të dy burrat në krye të shkallëve të spitalit. Mendojnë

se janë 2 truproja të armatosur, ndaj largohen menjëherë. Kjo skenë është prova e parë e shkëlqyer, në të gjithë trilogjinë (The Godfather II 1974, The Godfather III në vitin 1990), i një sërë skenash të paharrueshme që Al Pacino do t'i sjellë në kujtesën e spektatorit.

Në atë moment shohim metamorfozën e Michael, nga një hero lufte në një vrasës, për të “shpëtuar” jetën e babait të tij, dhe për të “ndëshkuar” policinë e korruptuar: vrasjen në restorant të mafiozitetit Sollozzo dhe shefit të policisë McCluskey që kishte miratuar atentatin ndaj Don Vitos, dhe që u përpoq ta eliminonte në spital.

Skena, e ndërtuar me një suspansë të atillë që të lë pa frymë, shkakton ende sot shumë emocione. Michael shkon në tualet duke i lënë që të dy në tavolinë, pasi u kontrollua për armë nga Sollozzo. Në tualet, ai kërkon me ankth armën e fshehur. Më pas rikthehet në tryezë.

Është shumë i tensionuar. Qëndron në një formë që krijon përshtypjen sikur nuk do të mundet ta realizojë hakmarrjen e tij. Kështu mendon spektatori. Më pas, si një gjarpër që bën sikur është në gjumë, nxjerr befafshëm armën. Në fillim qëllon mbi Sollozzo-n dhe më pas mbi kapitenin e policisë. Që të dy i godet në mes të ballit.

Por Coppola është edhe një mësues poezie. Këtë e shohim tek joshja, sipas traditës në Italianë e Jugut, që i bën Michael Apollonias në Siçili, ku fshihet

pas vrasjes së dyfishtë. Apo kortezhi i dasmës, midis shtëpive të qytetit, përgjatë urës së gurtë, një “fjongo e bardhë” pafajësie në mesin e një serie krimesh.

Një rindërtim filologjik i traditave popullore deri në detaje: skena përfundon me kremtimin e ceremonisë së përбетimit në latinisht. Kur bëhen bashkë Coppola dhe Puzo janë të paarritshëm, veçanërisht në shkrijen e kundërtave të jetës. Besimit të krishterë dhe mëkatit vdekjeprurës; lindjes dhe masakrës; të mirës dhe së keqes; Parajsës dhe Ferrit. Gjatë pagëzimit të nipit, djalit të motrës Connie dhe bashkëshortit të saj Carlo Rizzi (i cili shpesh e rreh atë), Michael ekzekuton të gjithë krerët e tjerë të familjes rivale të Nju Jorkut, duke përfshirë Tession, një ish-besnik të Don Vitos, që më pas i bashkohet bandës rivale.

Kohët e fundit, në një artikull të botuar në faqen e internetit të BBC-së, Nicholas Barber, kundërshtoi një shkrim të ekzagjeruar mbi filmin, që sipas tij ishte parë në mënyrë “feministe”, duke argumentuar se “nuk është e saktë të thuhet se gratë injorohen” nga Coppola. Në fakt siç e kujton edhe Barber filmi fillon me historinë e një vajze të çnderuar (vajza e Bonaseras). Unë do të shtoja edhe skena të tjera jo më pak të rëndësishme: nuses së tij të re Apollonia, Michael i kushton kohë duke e mësuar të ngasë makinën (jemi në vitin 1947!).

Po ashtu, Santino mbron motrën e tij kur ajo rrihet nga i shoqi

Carlo. Infermierja mund të ikte ose të refuzonte ta ndihmonte Michael të shpëtonte Don Vito. Kay e verbuar nga dashuria për Michael, nuk e sheh se si jetojnë ata njerëz, por do të ndërgjegjësohet në “The GodfatherII”.

Duke marrë parasysh mjedisin patriarkal në familjen Corleone, të rënduar nga konteksti mafioz dhe periudha historike, nuk na duket se skenari u jep personazheve femra vetëm rolet e grave të nënshtruara dhe pasive.

Juristë, gjyqtarë, pedagogë, sociologë e psikologë pyesin veten prej vitesh nëse një film, me një regji që nuk ka asnjë mangësi, me një skenar novator, dhe një kujdes të përsosur ndaj mjedisit historiko-sociologjik, me një kolonë zanore të rafinuar të Nino Rota, pa përmendur mjeshtrinë e madhe të aktorëve (Marlon Brando, Al Pacino, Diane Keaton, Robert Duvall, James Caan, Al Lettieri etj), ka të drejtë t'i kthejë atentatorët në heronj “pozitivë”.

Për këtë arsye, shikimi i kryeveprave të cilat mund të frymëzojnë admirim tek adoleshentët, edhe në aspektet etike negative, duhet të udhëhiqet nga edukatorë ekspertë. Duke iu shmangur leximit sipërfaqësor dhe imitimeve të lehta emocionale, dhe duke bërë dallimin midis realitetit dhe trillimit, midis ligjit dhe kriminit, ai që mbetet është arti i kinemasë. Ashtu si tek “Kumbari”. / “Formiche.net” – Bota.al



Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

Kosova nis përgatitjet për miqësoret ndaj Estonisë

Prishtinë, 26 nëntor - Përfaqësuesja e Kosovës në konkurrencën e femrave ka nisur përgatitjet për dy ndeshjet miqësore kundër Estonisë, që do të zhvillohen më 29 nëntor dhe 2 dhjetor në stadiumin "Fadil Vokrri", me fillim nga ora 13:00.

Futbollistet "dardane", nën drejtimin e përzgjedhësit Sami Sermaxhaj, janë shfaqur të motivuara dhe me atmosferë pozitive në stërvitjen e parë, duke u fokusuar maksimalisht në përgatitjet për këto dy teste të rëndësishme. Krahas aspektit miqësor, këto ndeshje do të shërbejnë si një mundësi e mirë për konsolidimin e konceptit të lojës në prag të ndeshjeve të Ligës C në Ligën e Kombeve, që nisin në shkurt të vitit të ardhshëm, e ku Kosova bën pjesë në grup me Maqedoninë e Veriut dhe Letoninë. Përzgjedhësi Sami Sermaxhaj ka theksuar rëndësinë e këtyre miqësoreve për ta vlerësuar formën e futbollisteve dhe për të ndërtuar një ekip sa më të kompletuar për ndeshjet e Ligës së Kombeve. "Përveç anës miqësore, kemi dy teste të mira që do të na shërbejnë për ta parë formën e lojtareve. Kemi bërë një grumbullim të mëparshëm dhe tani kemi afruar edhe tetë lojtare të reja. Afërsisht kemi kompletuar 90 për qind të lojtareve potenciale për Kombëtarën A dhe po i testojmë. Nga Kombëtarja U19 kemi tri-katër futbolliste me



potencial të lartë që së shpejti do t'i bashkohen ekipit A, por aktualisht janë të angazhuara në kualifikimet evropiane", ka thënë Sermaxhaj. Ai shtoi se përgatitjet janë fokusuar në arritjen e një ekipi konkurrues për Ligën C, me synimin që Kombëtarja e Kosovës të rikthehet sërish në Ligën B. "Herën e kaluar kemi zhvilluar lojë testuese me Kombëtarën U19. Kemi parë taktikat e trajnerit të ri. Tani kemi një kundërshtar më të fortë, siç është Estonia, dhe mund të përmirësojmë disa gjëra. Atmosfera është shumë e mirë dhe besoj se do të kemi një grumbullim të

suksesshëm. Qëllimi ynë është të rikthehemi në Ligën B dhe t'i fitojmë ndeshjet kundër Maqedonisë së Veriut dhe Letonisë", ka deklaruar Erëleta Memeti.

Edhe Donjeta Halilaj shprehi optimizëm për paraqitje të mira në dy ndeshjet kundër Estonisë: "Kjo është stërvitja ime e parë me trajnerin e ri. Miqësoret janë shumë të rëndësishme, pasi trajneri do të ketë mundësi ta shohë formën tonë dhe ku është ekipi. Besoj se do të jemi gati për sfidat që na presin dhe do ta arrijmë synimin tonë për t'u rikthyer në Ligën B".

SHKURT

Ylli ndërpret bashkëpunimin me tre amerikanë

KB Golden Eagle Ylli ka ndarë rrugët me tre basketbollistë amerikanë. Skuadra nga Suhareka që garon në Superligën e Kosovës ka konfirmuar largimin e lojtarëve të huaj. Në njoftimin e Yllit thuhet se kanë ndërprerë bashkëpunimin me marrëveshje të dyanshme dhe lojtarët në fjalë i ka falënderuar për kontributin si dhe u ka dëshiruar suksese në karrierë. Në fakt, amerikanin Terrell është i suspenduar prej datës 4 nëntor deri më 4 shkurt të vitit të ardhshëm nga Agjencia e Anti-Dopingut të Kosovës (KOSADA) për shkak se ka rezultuar pozitiv në testin e dopingut.

Të premtën bëhet tërheqja e shortit për Kupën në futboll

Të premtën, më 29 nëntor, në orën 13:00, në selinë e FFK-së do të bëhet tërheqja e shortit për rrethin e dytë të Kupës së Kosovës në futboll. Në këtë fazë të garave do të përfshihen edhe skuadrat e Superligës dhe Ligës së Parë, si dhe dy skuadrat nga rangjet më të ulëta që janë treguar të suksesshme në fazën e parë të garave. 32 ekipet pjesëmarrëse do të ndahen në dy vazo: në vazon e parë do të jenë 10 ekipet e Superligës, si dhe gjashtë ekipet e Ligës së Parë (tre të parat e Grupit A dhe 3 të parat e Grupit B), derisa në vazon e dytë do të jenë ekipet e tjera të Ligës së Parë dhe dy ekipet më të suksesshme nga rrethi paraeliminuar nga Liga e Dytë dhe Liga e Tretë.

Rrahmani: Jam një nga liderët e Napolit

Kapiteni i Kosovës, Amir Rrahmani, është duke e kaluar edicionin e pestë të skuadra e Napolit. Mbrojtësi i qendrës ndihet prej lojtarëve më të vlerësuar të skuadra e madhe italiane. "Është viti i pestë që jam këtu. Jam i lumtur sepse ndihem si një nga liderët në skuadër. Do të thotë që klubi dhe trajnerët që vijnë na japin besim dhe ne duhet ta tregojmë nivelin tonë çdoherë. Trajneri na tha se nuk duhej ta shikonim renditjen, por vetëm ndeshjen që do të luhej", ka thënë Rrahmani, shkruan të hënën "Corriere Azzurro". Rrahmani ka folur edhe për ecurinë e mirë që është duke e kaluar Napoli këtë edicion në Serinë A. "Shpresojmë të vazhdojmë kështu. Shpresojmë të pësojmë më pak gola dhe të ecim përpara si ekip. Është e vështirë të arrish rezultate në botën e futbollit, por të gjithë e nisim mirë së bashku dhe kur një sezon fillon kështu, qoftë edhe me fat, është më e lehtë të ecësh përpara", ka deklaruar Rrahmani. 30-vjeçari e fitoi titullin e kampionit të Serisë A me Napolin në edicionin 2022/2023.

Dabiqaj, 'Ylli i javës' në Superligë

Prishtinë, 26 nëntor - Federata e Futbollit e Kosovës dhe sponsori i Superligës, Albi Mall, vazhdojnë ta japin çmimin "Ylli i javës". Ky çmim për javën e 14-të në elitë i është dhënë futbollistit të FC Dritës, Albert Dabiqaj. Vlerësimi i më të mirit të javës është bërë nga Komisioni i Veteranëve të Futbollit në përbërje të Shyqeri Salihu, Bujar Asllani, Fatmir Mehmeti. Ky komision vendosi që çmimi "Ylli i javës" për xhiron e katërmbëdhjetë t'i takojë Albert Dabiqaj, i cili, përveçse shënoi het-trik në ndeshjen kundër KF Llapit, ishte njeriu më meritor i përmbysjes së rezultatit (3-1), duke i mundësuar ekipit të tij tri pikë të reja në krye të tabelës. "Kishim një ndeshje mjaft të vështirë, me Llapin u kthyem nga disavantazhi në 3-1. Të kthesh rezultatit nuk është aspak e lehtë. Personalisht, si Dabiqaj, ky ishte het-triku i parë në karrierën time në Superligë dhe ky është një moment i jashtëzakonshëm. Jam i lumtur me ecurinë e skuadrës dhe duhet të



vazhdojmë kështu. Në xhiron e ardhshme shkojmë te kampioni në fuqi, FC Ballkani, që është një skuadër e jashtëzakonshme dhe ka një ecuri si vendas të pamposhtur,

por ne do të shkojmë ta luajmë lojën tonë. Falënderoj bashkëlojtarët, stafin e trajnerëve, sepse pa ta nuk do të kaloja në këtë formë", ka thënë Dabiqaj për faqen zyrtare të FFK-së.

Leclercu i zhgënjyer nga Sainz: Tani e tutje do të fokusohem te vetja

Maranello, 26 nëntor - Charles Leclerc ka mbetur shumë i zhgënjyer nga gara e fundit e Formulës 1 në Las Vegas, ku u klasifikua në vendin e katërt, pas shokut të skuadrës Carlos Sainz. Edhe pse për Ferrarin ky mund të quhet një rezultat i mirë, për monogaskun fakti që

përfundoi pas spanjollit konsiderohet një humbje. Leclerc përdori fjalë të ashpra ndaj Sainzit që, sipas tij, nuk ishte i respektueshëm kur e parakaloi pas ndalesës së dytë. “Nuk do të hyj në detaje për sjelljen e Carlosit, ka disa gjëra që i themi një-tjetrit dhe sot kanë shkuar

pak më ndryshe, por nuk ka asgjë”, u shpreh Charles Leclerc. “Në fund përfunduar në vendin e 3-të dhe të 4-të. Asgjë nuk ndryshon për ekipin, por më vjen pak keq për botërorin e pilotëve. Unë jam duke luftuar me Norrisin për vendin e dytë, por e di që

duhet të mbështetem te vetja në dy garat e mbetura”, u shpreh më tej monogasku i “kokëkuqes”. “Duhet të paraqitem më mirë në provat zyrtare. Tani e tutje do të fokusohem te vetja dhe do të përpiqem të maksimizoj gjithçka. Po rikuperojmë, por pjesa e parë e sezonit ishte



ajo që në penalizoi, ndërsa në sezonin e dytë dhe të tretë mendoj se ishim më të shpejtë se rivalët”, ka deklaruar Leclerc.

Gjermanët paralajmërojnë tifozët: Kujdes në Beograd, droga dhe mashtrimet nuk janë të rralla

Stuttgart, 26 nëntor - Crvena Zvezda pret sot (e mërkurë) Stuttgartin në ndeshjen e xhiros së pestë të Ligës së Kampionëve, ndërsa me skuadrën gjermane në Beograd do të arrijnë edhe tifozët e klubit nga Bundesliga. Portali gjerman “Swr” nuk ka pasur shumë fjalë lavdëruese për kryeqytetin serb, ndaj kanë dërguar një paralajmërim për tifozët e tyre. “Atmosfera në Beograd është e nderz dhe ultrasit e Zvezdës janë të njohur për sjelljen e tyre të dhunshme. Edhe tuneli për lojtarët në stadium duket më shumë si një bunker luftime sesa një tunel stadiumi. Ndryshe nga vizitat në Madrid apo Torino, ndoshta nuk do të ketë mbledhje të mëdha të tifozëve në Beograd në sheshet ku dikush do të festonte apo brohoriste duke theksuar publikisht përkatësinë e klubit, duke kënduar këngë dhe duke ecur me zë të lartë në rrugë”, shkruan fillimisht portali gjerman. Ata, po ashtu, u kanë kujtuar



lexuesve se Serbia nuk është në Bashkimin Evropian dhe se për të shkuar në Beograd do t'u duhet pasaporta, ndërsa ka këshilla të veçanta për ata që do të shkojnë në ndeshje me makinë. “Parkoni vetëm afër hotelit sepse Crvena Zvezda nuk rekomandon parkimin afër stadiumit. Taksitë duhet të porositen ekskluzivisht nga hotelet ose restorantet sepse tentativat për mashtrim kur ndaloni në rrugë janë një dukuri e zakonshme në Beograd.

Droga dhe pastrimi i parave nuk janë të rralla në Beograd. Një metropol me pothuajse 1,5 milion banorë, qyteti në Danub njihet si kryeqyteti i argëtimit, por uji nga shatërvani nuk është i përshtatshëm për t'u pirë, nuk ka sistem të trajtimit të ujërave të zeza të Beogradit, në lumenjtë Sava dhe Danubi”, thonë gjermanët. Kujtojmë se ndeshja në mes të Crvena Zvezdës dhe Stuttgartit do të luhet nesër në Beograd me fillim nga ora 18:45.

Oklahoma sërish lidere në Perëndim, zhgënjëjnë Golden State dhe Denveri, fiton Bostoni

Boston, 26 nëntor - Bostoni ka fituar me rezultat 126-94 ndaj Clippersave dhe qëndron në vendin e dytë në Konferencën e Lindjes. Ndeshje pa histori, ku kolektiviteti i Celticsit bëri diferencën në fushë, me gjashtë lojtarë që realizuan mbi 16 pikë. Oklahoma rikthehet në krye të renditjes në Konferencën e Perëndimit pas fitores me rezultat 130-109 në fushën e Sacramento. Për miqtë u dallua Alexander Shai, autor i 37 pikëve dhe 11 asistime, më i miri në fushë. Zhgënjëu ekipi i Golen States, që u mund në shtëpi me rezultat 128-120 nga



Brooklyni, sfidë ku për miqtë u dallua Schroder me 31 pikë. Edhe Denveri humbi në fushën e vet, 145-118 nga New York, ku Anunoby realizoi 40 pikë. Skuadra e Dallasit, falë 23

pikëve të Irvingut, mundi me rezultat 129-119 Atlantan, ndërsa Orlando fitoi me rezultat 95-84 në fushën e Charlottes, ndeshje ku lojtarët e stolit realizuan 53 pikë.

REZULTATET

Charlotte - Orlando	84-95
Detroit - Toronto	102-100
Indiana - New Orleans	114-110
Atlanta - Dallas	119-129
Boston - Clippers	126-94
Memphis - Portland	123-98
Denver - New York	118-145
Golden State - Brooklyn	120-128
Sacramento - Oklahoma	109-130

Kirurgu plastik e padit Ronaldon

Përvoja e dytë në Manchester United për Cristiano Ronaldo nuk ishte aspak pozitive në fushën e bletë, por yllit portugez i ka dalë problem edhe jashtë fushës për atë periudhë. Në fakt, kirurgu plastik Roshan

Ravindran e ka paditur 39-vjeçarin me pretendimin se ia ka atij borxh 48 000 euro për shërbimet që ia kishte bërë ish-futbollistit të Sporting Lisbonës, Real Madridit e Juventusit dhe anëtarëve të familjes së tij. Sipas

tij, pesë herë fituesi i “Topit të Artë” dhe pesë herë fituesi i Ligës së Kampionëve i detyrohet atij për trajtimet e ofruara kur ishte në “Old Trafford” në vitet 2021 e 2022. Specializimet e ish-kardiologut përfshijnë botoksin

dhe fillerat, kujdesin e lëkurës dhe ngritjen e vetullave. Ai nuk e përmend partneren e lojtarit, Georgina Rodríguez, por pretendon se ka punuar për Ronaldon “dhe anëtarët e familjes së futbollistit” në

klunikën e tij “Cheshire”. I pyetur në lidhje me padinë nga tabloidi britanik “The Sun”, mjeku Rosh theksoi: “Ka një çështje ligjore në vazhdim dhe, si profesionist, nuk diskutoj për pacientët e mi”.

SHKURT

Trajneri i Islandës jep dorëheqje para ndeshjes me Kosovën në Ligën e Kombeve


Trajneri i Islandës, Age Hareide, e ka njoftuar Federatën e Futbollit të Islandës për dorëheqjen e parevokueshme si trajner i ekipit kombëtar. Kosova do të ndeshet me Islandën në kuadër të ndeshjes “play-off” për promovim në Ligën B të Ligës së Kombeve. Ndeshjet mes “dardanëve” dhe ishullit nordik do të zhvillohen gjatë muajit mars 2025, por Islanda ka pësuar ndryshime tashmë. Trajneri Hareide ka dhënë dorëheqje nga ekipi kombëtar dhe drejtuesit e Federatës Islandeze e kanë pranuar atë. “Age Hareide ka vendosur të tërhiqet si trajner i Kombëtares A të meshkujve dhe për këtë arsye ka dhënë dorëheqje me iniciativën e tij. Hareide mori skuadrën nga Arnar Vidarsson në prill 2023 dhe e drejtoi atë në një total prej 20 ndeshjesh. Federata Islandeze e Futbollit falënderon Agën për punën e tij dhe i uron gjithë të mirat”, thuhet në njoftim. Pas largimit, Hareide ka treguar arsyen e dorëheqjes. “Unë e kam shijuar kohën e time me kombëtaren islandeze, por besoj se tani është koha e duhur për t'u pensionuar. Ka kohë emocionuese përpara për ekipin dhe shumë lojtarë të rinj që të rriten si lider të ekipit. Uroj ekipin dhe futbollit islandez gjithë të mirat në të ardhmen”, ka thënë Hareide.

Zbulohen 10 favoritët për ta fituar ‘Topin e Artë 2025’

As një muaj nuk ka kaluar që kur Rodri u shpall fitues i “Topit të Artë” për vitin 2024. Për vitin e ardhshëm, “GOAL” ka zbuluar dhjetë favoritët për ta fituar këtë çmim. Vendin e parë e zë Mohamed Salah, i cili ndiqet nga Robert Lewandowski. I treti në listë është Raphinha i Barcelonës, ndërsa Vinicius i Real Madridit pozicionohet i katërti. Musiala nga Bayern Muncheni zë pozitën e pestë. Yamal, Haaland, Kane e Gyokeres zënë pozitën e tjerë. Ndërsa i dhjeti për momentin në këtë listë edhe Kylian Mbappe, i cili nuk po kalon në ditë të mira te Real Madridi.

Bryon: PSG-ja e paguante Neymarin 200 mijë euro për duartrokitje

PSG-ja bëri bujë të madhe më 2017 kur pagoi 222 milionë euro për t'i siguruar shërbimet e Neymar JR. Mirëpo, shifra të çmendura paguante edhe për pagën e brazilianit, duke paguar mbi 160 milionë euro sa ai ishte pjesë e klubit. Por, ajo se çfarë mori vëmendjen ditën e fundit, ishte një lajm që qarkulloi rreth një klauzole të çuditshme të brazilianit. Raportohet se ai fitonte 200 mijë euro, nëse pas ndeshjes do të shkonte te tifozët për t'i duartrokitur. Kështu ka thënë ish-futbollisti i Crystal Palaces, Lewis Bryon. “Klauzola më e çmendur që kam dëgjuar ishte ajo e Neymarit te PSG-ja. Një anëtar i stafit të PSG-së që ishte në klub gjatë kohës së Lionel Messit, Neymar dhe Kylian Mbappe, nuk dua ta zbuloj emrin e tij, më tha se Neymar kishte një klauzolë në kontratë, sipas së cilës, nëse do të vinte për t'i duartrokitur tifozët pas ndeshjes, do të merrte një bonus prej 200 mijë eurosh”, tregon Bryon.



NDËRMARRJA PUBLIKE LOKALE
LOCAL PUBLIC ENTERPRISE
NPL "KU'ZINA" SH.A.
PRISHTINË
Nr. 0524 Dt. 27.11.2024

Ndërmarrje publike lokale | Rr. Egnatia p.n. - 10 000 Prishtinë | www.kuzhina.net | kuzhinaqendrore@gmail.com | tel: +383 45 709 106

Prishtinë, 27.11.2024

Në bazë të dispozitave të nenit 21 të Ligjit nr. 03/L-087 Për Ndërmarrjet Publike ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 31/15 qershor 2008), respektivisht nenit 13 të Ligjit nr. 04/L-111 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 03/L-087 Për Ndërmarrjet Publike (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" nr. 13/30 maj 2012) dhe në bazë të Udhëzimit Administrativ MFPT nr. 01/2024 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, Bordi i Drejtorëve NPL "KU'ZINA" SH.A. me seli në Prishtinë, në mbledhjen e mbajtur me datë 27.11.2024, mori vendim të PUBLIKOJ:

KONKURS PUBLIK Për plotësimin e një (1) pozitë

I. Titulli i vendit të punës: Kryeshef Ekzekutiv

Vendi: Prishtinë.
Ndërmarrja: NPL "KU'ZINA" SH.A. me seli në Prishtinë.
I përgjigjet: Bordit të Drejtorëve.
Mandati: 3 vite

II. Lartësinë e pagës mujore për vendin e punës;

Kompensimi dhe përfitimet e Kryeshefit Ekzekutiv do të përcaktohen nga Bordi i Drejtorëve i NPL Ku'zina sh.a.

III. Kriteret e përgjithshme dhe të veçanta për vendin e punës;

Të gjithë kandidatët potencial të jenë persona me integritet të lartë të cilët i plotësojnë kushtet e kualifikimit sipas nenit 17.1, të Ligjit për Ndërmarrjet Publike dhe kanë përvojën e nevojshme profesionale dhe shkollimin e kërkuar për pozitën në fjalë. Përveç këtyre kushteve të përgjithshme, kandidatët duhet të plotësojnë edhe këto kushte të veçanta:

- Të posedojë diplomë universitare master apo Bachelor Fakulteti Ekonomik, Juridik, apo fusha të tjera relevante.
- Të posedojë përvojë menaxheriale (5) pesë vite.
- Të ketë shkathësi organizative, menaxhuese dhe të komunikimit.
- Të ketë njohuri të nevojshme të punës me kompjuter për detyra dhe përgjegjësitë e vendit të punës.
- Të plotësojë kushtet e kualifikimit sipas nenit 17.1 të Ligjit nr. 03/L-087 të Ndërmarrjeve Publike.
- Njohja e gjuhës angleze (e dëshirueshme);

VII. Datën dhe orën e saktë të përmbylljes së konkursit;

Konkursi publik është i hapur në kohëzgjatje prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditë kalendarike dhe atë nga data 27.11.2024 deri me datën 11.12.2024.

VIII. Mënyra e aplikimit në konkurs

Aplikimi për konkurs bëhet vetëm në mënyrë elektronike, nëpërmjet adresës elektronike kuzhinaqendrore@gmail.com dhe në kohë reale do të sigurohet kthimi i informatës mbi pranimin e dokumenteve të dërguara nga kandidatët. Zyra Ligjore ofron sqarime të nevojshme për kandidatët lidhur me kriteret e konkursit publik gjatë fazës së aplikimeve. Formulari për kërkesë (aplikim) dhe Deklarata nën betim, mund të shkarkohen nga webfaqja e NPL "KU'ZINA" SH.A. www.kuzhina.net ose mund të merren në zyrat e Ndërmarrjes.

IX. Mënyrën e vlerësimit dhe kriteret e poentimit;

Vlerësimi i kandidatëve zhvillohet nëpërmjet intervistimit (testim me gojë). Procedura e vlerësimit të konkursit publik përmban gjithsej njëqind (100) pikë, ku kalueshmëria është arritja e së paku pesëdhjetë e pesë (55) pikëve nga të gjitha fazat e konkursit publik.

X. Një kalendar të përafërt të procedurës të rekrutimit;

Brenda shtatë (7) ditësh pas mbylljes së afatit të konkursit, bordi i drejtorëve bën verifikimin paraprak të aplikacioneve, me qëllim të konstatimit të përmbushjes së kriterëve të konkursit nga kandidatët sipas aplikacioneve të pranuar.

XI. Shënimi që aplikacionit e dërguara pas afatit nuk do të shqyrtohen.

Aplikacionet e dërguara pas datës 11.12.2024 nuk do të shqyrtohen. Do të kontaktohen vetëm kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret e përcaktuara dhe përfshihen në listën e ngushtë.

Bordi i NPL Ku'zina
z. Petrit Abdullahu, Kryesues
znj. Naime Beqiraj, anetare
z. Ergyn Janovali, anëtar
znj. Mimoza Xhaka Bllacaku



Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, Kompania "LTS KOSOVO" LLC, Graçanicë në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe komunën organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për Impiantin e Përpunimit të Profileve Metalike, në Konjuh, Lipjan.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 30.01.2025 në ora 10:00 në objektin e Komunës së Lipjanit, Adresa; Rruga "Shqipëria", Lipjan.

do të organizohet debat publik nga Kompania "LTS KOSOVO" LLC, Graçanicë, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Komunën.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

https://eu-central-1.protection.sophos.com?d=zoom.us&u=aHR0cHM6Ly91czA0d2ViLnpyb20udXMvcv80NTQ5Mz00NDk1P3B3ZD1HYktjb2NjU1d4MzIzUUY3UHNBa0NNM2J2SzYuMQ==&i=NjY1ZjJjOWVIZmMxZjE3Nzc3ZWMxNzcy&t=Mnh5R0tSSG1OTIM1Wk9BdGtQZU14S3E1eTQ0MmsvNnZxZU5zSW5XSC9nMD0=&h=c53cf73b4eb54f0c96e8a636ffbfd24e&s=AVNPUehUTONFTkNSWVBUSVaTRAueU-vNbNdW92a0FAisFOgf0Rln55_29at16bUHiQ

Meeting ID: 454 934 4495
Passcode: Aela2019.

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për Kompaninë "LTS KOSOVO" LLC, Graçanicë, për Impiantin e Përpunimit të Profileve Metalike, në Konjuh, Lipjan.

<https://mmphi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2>

Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin vnm.komente@rks-gov.net

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon në implementimin e projektit.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- **Sheshoj banesën e re me qera në dëftesë Q.K "11 Marsi" Prizren.**

qendër prapa teatrit Kombëtar, me

- Bardh Krasniqi shpall të pavlefshme diplomën Q.K. "11 Marsi" Prizren.

sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka

- Enrik Shtufi shpall të pavlefshme diplomën Q.K "11 Marsi" Prizren.

të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro.

Banesa lëshohet për afate të gjata

- Arilon Krasniqi shpall të pavlefshme dëftesat enkl VI - IX shfm " Brigada 125 " Medvec.

dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

- Pranvera Minci shpall të pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfm " Fadil Hisari " Prizren.

- Lëshoj banesë me qira, penthouse.

Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka

- Flandra Bytyqi shpall të pavlefshme diplomën Q.K "11 Marsi " Prizren.

150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të

na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën një dhomshe me qira , ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroi i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.





ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Caseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales





MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA

1992

